



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT  
AKADEMIA E SIGURISË

Nr. 2444/1 Prot.

Tiranë, më 10 .09.2024

**NJOFTIM**

Akademia e Sigurisë shpall konkursin për 1(një) vend pune të lirë për personel administrativ, klasa I, funksioni Sanitar, në Sektorin Ekonomik, Struktura Administrative, në Akademinë e Sigurisë.

Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere;

**1- Kritere të Përgjithshme**

1. Te jete shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të ketë përfunduar arsimin e mesëm
3. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
4. Të ketë figurë të pastër morale ;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;

**2- Kritere të veçanta**

1. Të ketë eksperiencë pune të ngjashme;
2. Të ketë aftësi për të punuar në grup;

**3- Kandidatët konkurrues duhet të paraqesin në Akademinë e Sigurisë dokumentat e mëposhtme:**

1. Kërkesë me shkrim.
2. Kopje të njehsuar të dokumenteve diplomë (përfshirë dhe listë notash, letërnjoftimi (ID). Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim Gjykate dhe Prokurorie.
6. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
7. Vërtetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar(SPAK);
8. 2 fotografi me permasat 4x6.

